

VENDIM
Nr. 324, datë 18.5.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE DHE KUSHTEVE QË DUHET TË
PLOTËSOJË NJË STANDARD MATJEJE PËR T'U DEKLARUAR ETALON
KOMBËTAR MATJEJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Deklarimi si etalon kombëtar matjeje ka si synim arritjen e gjurmueshmërisë metrologjike, në kuadër të mirëpërcaktimit, riprodhimit, realizimit dhe ruajtjes së njërive bazë të matjes Së Sistemit Ndërkombëtar të Njësive të Matjes (SI), përfshirë shumëfishat dhe nënfishat e tyre, në përputhje me përparësitë e përcaktuara në planin afatgjatë për zhvillimin e etaloneve kombëtare të matjeve, të miratuar nga ministria përgjegjëse për ekonominë, në zbatim të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr. 126/2021, “Për metrologjinë”.

2. Përveç përkufizimeve të dhëna në nenin 3, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”, termat në vijim kanë këto kuptime:

a) “CIPM MRA” një marrëveshje ndërkombëtare për njohjen reciproke të etaloneve kombëtare të matjes dhe certifikatave të kalibrimit dhe matjeve, të lëshuara nga institucionet kombëtare të metrologjisë, e miratuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Peshave dhe Masave nën autoritetin e Konventës së Metrit;

b) “CMC” aftësitë matëse dhe kalibruese të njohura ndërkombëtarisht sipas CIPM MRA-së, të cilat ruhen në bazën e të dhënave të Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave (në vijim, BIPM). CMC-ja e miratuar dhe të dhënat teknike mbështetëse janë të disponueshme publikisht në databazën e të dhënave (KCDB), sipas CIPM MRA-së;

c) “Fusha e njohjes” fusha e një njësie matjeje individuale të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive të Matjes (SI), për sa u takon madhësive fizike, dhe fusha e matjeve referencë e disa mostrave për të përcaktuar parametrat e një substance, duke përfshirë përcaktimin e parametrave të matur;

ç) “Krahasim ndërkombëtar ndërlaboratorik” një krahasim në të cilin një laborator krahason aftësitë e tij matëse në një fushë të caktuar dhe për një madhësi të caktuar me aftësitë matëse të laboratorëve të tjerë në nivel ndërkombëtar. Këto janë krahasime ndërlaboratorike brenda BIPM-së dhe krahasime ndërlaboratorike brenda Organizatës Rajonale Evropiane të Metrologjisë (EURAMET), ose krahasime rajonale ndërlaboratorike, nëse ato përfshijnë të paktën një institut të huaj të metrologjisë, që është anëtar me të drejta të plota i EURAMET-it ose i njëres prej organizatave të tjera rajonale metrologjike;

d) “Vlerë referencë” vlera që jepet nga një laborator, në përputhje me një procedurë të qartë matjeje të njohur e validuar, që siguron gjurmueshmërinë e kësaj vlere te njësitë e Sistemit Ndërkombëtar të Njësive të Matjes (SI).

II. KËRKESAT DHE KUSHTET PËR NJOHJEN E NJË ETALONI KOMBËTAR TË MATJES

1. Një standard matjeje të njihet si etalon kombëtar për një fushë të caktuar matjeje, kur plotëson këto kërkesa:

1.1 E siguron gjurmueshmërinë metrologjike nëpërmjet:

a) kalibrimit të rregullt periodik në nivel ndërkombëtar deri te Sistemi Ndërkombëtar i Njësive të Matjes (SI); ose

b) rezultatit të një krahasimi kyç ndërlaboratorik ndërkombëtar, në rastet kur bëhet fjalë për realizim primar të një etaloni; ose

c) transferimit të vlerës referencë, duke përdorur metoda referencë, kur bëhet fjalë për material referues.

1.2 Zotëron karakteristikat më të mira metrologjike, lidhur me diapazonin e matjes, saktësinë dhe pasigurinë e matjes në Republikën e Shqipërisë, e dokumentuar kjo nëpërmjet aftësive matëse dhe kalibruese (CMC) të akredituara nga një trupë akreditimi nënshkruese e një marrëveshjeje shumëpalëshe për njohjen reciproke të dokumenteve të akreditimit, për kalibrimin e testimit, në përputhje me standardin për kompetencën teknike të laboratorëve të testimit dhe kalibrimit, ISO/IEC 17025:2017; dhe raporteve të pjesëmarrjes periodike në krahasime ndërlaboratorike ose teste të zotësisë, të organizuara në përputhje me kërkesat e standardit SSH ISO/IEC 17043:2010, “Vlerësimi i konformitetit – kërkesa të përgjithshme për testet e zotësisë”.

2. Një etalon matjeje, që plotëson kërkesat e pikës 1, të këtij kreu, deklarohet etalon kombëtar matjeje, kur institucioni mbajtës i tij plotëson këto kushte:

2.1 I përdor etalonet e matjes vetëm për sigurimin e gjurmueshmërisë metrologjike për etalonet e tjera të nivelit më të ulët dhe, nga përdorimi i tij, lëshon vetëm certifikata dhe raporte të akredituara nga një trupë akreditimi, nënshkruese e një marrëveshjeje shumëpalëshe për njohjen reciproke të dokumenteve të akreditimit për kalibrimin e testimit, në përputhje me standardin për kompetencën teknike të laboratorëve të testimit dhe kalibrimit, SSH ISO/IEC 17025:2017;

2.2 I përdor etalonet e matjes për kërkimin dhe zhvillimin shkencor për fushën përkatëse të matjeve, me qëllim përmirësimin e parametrave të tij metrologjikë.

3. Nuk lejohet përdorimi i etalonit kombëtar për kalibrime dhe matje, që mund të kryhen me etalone të një niveli më të ulët të saktësisë.

4. Për një fushë të caktuar të matjeve të njihet dhe të deklarohet vetëm një etalon kombëtar.

5. Laboratori mbajtës i një etaloni kombëtar matjeje ka përgjegjësi të plotë për rezultatet e kalibrimeve dhe matjeve që kryen.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 1160, datë 13.8.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për etalonet kombëtare të matjes”, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama